



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr.165**

**24 dhjetor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 808, datë 31.10.2012	Për lirim nga detyra..... 9071
Vendim i KM nr. 849, datë 6.12.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar..... 9071
Vendim i KM nr. 852, datë 21.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të së ndjerës Esmeralda Uruçi..... 9072
Vendim i KM nr. 853, datë 4.12.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Zagori” dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.... 9072
Vendim i KM nr. 868, datë 12.12.2012	Për lejimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratës, me objekt “Shtypja e Fletores Zyrtare të të tretët, për vitin 2012”, si autoritet kontraktor..... 9073
Vendim i KM nr. 875, datë 19.12.2012	Për fondin e ekselencës për mbështetje financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj të shkëlqyer..... 9073
Vendim i KM nr. 877, datë 12.12.2012	Për disa ndryshime dhe një shtesë në vendimin nr. 708, datë 24.10.2012 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të projektit “Dekori i 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë””..... 9076
Udhëzim i MB nr. 374, datë 10.12.2012	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin..... 9076

**VENDIM**  
**Nr. 808, datë 31.10.2012**

**PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Znj. Filloreta Kodra, Zëvendësministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 849, datë 6.12.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 23.4.2011 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 9 e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet, si më poshtë vijon:

“9. Përgjashtimisht për vitin 2012, fondi i veçantë nuk përdoret për shpërblimin e punonjësve për rezultate të mira në punë, për shpërblime të parashikuara me akte të tjera, ligjore apo nënligjore, për dhënie ndihmash të menjëhershme në raste fatkeqësish dhe në raste të tjera, si dhe për veprimtari social-kulturore.”.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr. 852, datë 21.11.2012**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË  
SË NDJERËS ESMERALDA URUÇI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 6 600 000 (gjashtë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të së ndjerës Esmeralda Uruçi.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
  3. PAGESA TË BËHET ME PARAQITJEN E FATURAVE PËR SHËRBIMIN E OFRUAR.
  4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 853, datë 4.12.2012**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “ZAGORI” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË  
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve “Zagori” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “Albhydro” sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Zagori”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr. 868, datë 12.12.2012**

**PËR LEJIMIN E QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE PËR KRYERJEN E  
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT DHE LIDHJEN E KONTRATËS, ME OBJEKT  
“SHTYPJA E FLETORES ZYRTARE TE TË TRETËT, PËR VITIN 2012”, SI AUTORITET  
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratës me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2012, për objektin “Shtypja e Fletores Zyrtare te të tretët, për vitin 2012”, me fond limit 10 285 440 (dhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e dyzet) lekë, pa TVSH.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Qendra e Botimeve Zyrtare dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr. 875, datë 19.12.2012**

**PËR FONDIN E EKSELENCËS PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË STUDENTËVE E  
SHKENCËTARËVE TË RINJ TË SHKËLQYER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e një fondi të veçantë, të financuar nga Buxheti i Shtetit, në masën deri në 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë lekë) në vit, si edhe nga donacione, për mbështetje financiare të studentëve dhe shkencëtarëve shqiptarë të shkëlqyer, i cili përdoret nga Ministria e Arsimit dhe



Shkencës për bursa të posaçme për studentë që ndjekin studime “Bachelor”, “Master” ose të doktoratës jashtë shtetit në universitetet më të mira të botës, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij vendimi.

2. Të drejtën për t’u mbështetur financiarisht e kanë:

a) Studentët, që ndjekin studimet e plota të doktoratës ose një pjesë të tyre jashtë shtetit në njërin prej 15 universiteteve më të mira të botës në shkencat shoqërore të artit dhe të sportit; në njërin prej 50 universiteteve më të mira të botës në shkencën e matematikës, shkenca natyrore, teknike, teknologji, shkenca të edukimit dhe ato të jetës, sipas renditjes së zhvilluar nga *Times Higher Education* “Renditja botërore e universiteteve”, për vitin më të fundit; si dhe në njërin prej universiteteve të mirënjohura të botës për studimet në albanologji, pasi kanë përfunduar ciklin e parë e të dytë të studimeve universitare, kur:

i) kanë arritur notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës, dhe mbi 9.5, për shkencat ekonomike e shoqërore për studimet e kryera brenda vendit; ose, përkatësisht, mbi 8 (e barasvlershme me vlerësimin B në sistemin anglo-sakson), për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës, dhe mbi 8.5 (e barasvlershme me vlerësimin B + në sistemin anglo-sakson), për shkencat ekonomike e shoqërore, për studimet e kryera jashtë shtetit në secilin cikël studimi;

ii) janë pranuar në një universitet të huaj për studimet e doktoratës, pa pagesë për tarifa studimesh dhe nuk marrin pagë ose shpërblim për punën kërkimore apo mësimore që bëjnë gjatë këtyre studimeve në universitetin pritës;

iii) kanë përgatitur një projekt për kërkim gjatë studimeve të doktoratës jashtë shtetit dhe të gjitha shpenzimet e projektit kërkimor janë marrë përsipër nga universiteti pritës;

iv) pranojnë të punojnë, së paku 3 (tre) vjet, në Shqipëri, pas përfundimit të studimeve të doktoratës jashtë shtetit;

v) nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar dhe nuk kanë të ardhura personale dhe të familjarëve të tyre (prindërit, adoptuesi, bashkëshortët, fëmijët dhe i adoptuari deri në moshën tetëmbëdhjetë (18-vjeçare) mbi 200 000 (dyqind mijë) lekë në muaj.

b) Studentët, që ndjekin jashtë shtetit ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve universitare, kur:

i) janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së zhvilluar nga *Times Higher Education* “Renditja botërore e universiteteve”, në vitin më të fundit, për të ndjekur njërin nga dy ciklet e studimit në matematikë, shkenca natyrore të edukimit, teknike, teknologji të jetës, artit dhe sportit;

ii) janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së zhvilluar nga *Times Higher Education* “Renditja botërore e universiteteve”, në vitin më të fundit, për të ndjekur njërin nga dy ciklet e studimit në shkencat shoqërore dhe kanë përfituar një pjesë të financimit nga universiteti pritës;

iii) pranojnë të punojnë, së paku, 3 (tre) vjet në Shqipëri pas përfundimit të ciklit përkatës të studimeve, për të cilin përfitojnë bursën ose pas përfundimit të të gjithë ciklit të studimeve, nëse kandidati përfitues vijon studimet në ciklet më të larta universitare;

iv) nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar dhe nuk kanë të ardhura personale dhe të familjarëve të tyre (prindërit, adoptuesi, bashkëshortët, fëmijët dhe i adoptuari deri në moshën tetëmbëdhjetë (18-vjeçare) 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë në muaj.

v) kanë përfunduar studimet parauniversitare me mesatare mbi 9, të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose ekuivalente për ata që kanë përfunduar këto studime jashtë vendit, për studentët që aplikojnë për ciklin e parë të studimeve universitare;

vi) kanë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës, dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore ose përkatësisht mbi 8 (e barasvlershme me vlerësimin B në sistemin anglo-sakson) për shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës, dhe mbi 8.5 (e barasvlershme me vlerësimin B+ në sistemin anglo-sakson) për shkencat

ekonomike e shoqërore, për studimet e kryera jashtë shtetit, për studentët që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve universitare.

3. Rregullat e hollësishme për zbatimin e kritereve, si dhe për masën e financimit për çdonjërin nga bursat e parashikuara, që aplikohen për studentët dhe shkencëtarët e rinj, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, i cili botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kriteret për përzgjedhjen e shkollave të larta jashtë shtetit, në raport me koston e kualifikimit, fushat parësore, numrin e bursave për secilën kategori, në varësi edhe të fondit të vënë në dispozicion për këtë qëllim, konsultohen me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

5. Përzgjedhja e kandidatëve kryhet para fillimit të çdo viti akademik nga komisione përzgjedhëse të ngritura me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Këto komisione kanë në përbërje profesorë të universiteteve, në varësi të fushës, si dhe një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kur fondi i veçantë plotësohet edhe nga donacione, në komision merr pjesë edhe një përfaqësues i donatorëve. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Udhëzimi botohet edhe në Fletoren Zyrtare.

6. Lista përfundimtare e kandidatëve të përzgjedhur dhe masa e bursës për secilin prej tyre miratohen nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, pasi kandidati të ketë nënshkruar deklaratën, e miratuar nga Ministri, për punësim në Shqipëri. Lista botohet në faqen në internet të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Studentët, të cilët ndërpresin studimet për më shumë se një muaj, përveç rasteve kur paraqesin raport mjekësor, humbin të drejtën e përfitimit të mëtejshëm të bursës së studimit. Studentët, të cilët nuk i japin të gjitha provimet apo e përfundojnë vitin me notë mesatare më të ulët se nota 8 (vlerësimi ndërkombëtar, sistemi anglo-sakson B), nuk përfitojnë bursë në vitin pasardhës.

8. Studentët dhe shkencëtarët e rinj, që kanë përfituar bursë, sipas këtij vendimi, dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës, i ndërpresin ato ose kur, pas përfundimit të studimeve, refuzojnë të punojnë në Shqipëri, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur, detyrohen t'i kthejnë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës shumën e marrë në formë burse.

9. Masa e fondit të veçantë për mbështetje financiare për shkencëtarë të rinj shqiptarë të shkëlqyer, për vitin 2012, është 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë, e cila është planifikuar në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

10. Ky vendim zbatohet për të gjithë studentët që aplikojnë për herë të parë për fondin e ekselencës nga viti 2012 e në vazhdim.

11. Vendimi nr. 554, datë 7.7.2010 i Këshillit të Ministrave "Për fondin e ekselencës për mbështetje financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj të shkëlqyer", i ndryshuar, do të vazhdojë të zbatohet për studentët që janë shpallur fitues përpara vitit 2012 deri në përfundimin e studimeve përkatëse.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr. 877, datë 12.12.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 708, DATË 24.10.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT “DEKORI I 100-VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 708, datë 24.10.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe për Ministrinë e Punëve të Jashtme.”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e vitit 2012, në zërin “Projekte”, artikulli 604, t’i shtohen, përkatësisht, fondet:

a) 17 637 600 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të projektit “Dekori i 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”;

b) 27 978 624 (njëzet e shtatë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekë, për mbulimin e shpenzimeve për dekor, transmetimin e spoteve dhe mbulimin e pjesës së shpenzimeve për koncertin në Bruksel, në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë.”.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në Buxhetin e Vitit 2012, në artikullin 602, t’i shtohet fondi në shumën 2 840 000 (dy milionë e tetëqind e dyzet mijë) lekë, për mbulimin e pjesës së shpenzimeve për koncertin në Bruksel, me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr. 374, datë 10.12.2012**

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 49, 50, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të dekretit nr. 7841, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”,

## UDHËZUJ:

1. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat e zgjedhësve gjenerohen automatikisht në afatet që parashikon ligji, nga RKGJC-ja dhe janë të vlefshme në ndërfaqen grafike *online* të RKGJC-së. Procedura e gjenerimit të ekstrakteve dhe listës së zgjedhësve është funksionalitet i sistemit të RKGJC-së, ku përgjegjësi i ZGJC-së shkarkon nga RKGJC-ja përbërësit zgjedhorë për zgjedhësit që i përkasin kësaj ZGJC-je, si më poshtë: duke përzgjedhur te menuja në të majtë të faqes së RKGJC-së, opsionin “Procesi i regjistrimit” “Raportime” dhe zgjedh listën.

2. RKGJC-ja gjeneron formatin elektronik të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë brenda datës 18 dhjetor 2012, të ndarë sipas qendrave të votimit të zgjedhjeve të datës 8.5.2011 për çdo bashki/njësi bashkiake/komunë.

3. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kontrollon raportin ditor, për numrin e zgjedhësve për çdo qendër votimi. Kur vëren në raportin ditor se ka qendra votimi me më pak se 200 zgjedhës apo qendra votimi me më shumë se 1000 zgjedhës (700 zgjedhës për qarkun Tiranë për njësitë vendore sipas vendimit të KQZ-së), njofton, brenda 48 orëve, kryetarin e bashkisë/njësisë bashkiake/komunës. Këto lista gjenden në formatin e posaçëm kanë të shkruar në sfond “jo për afishim” dhe mund të përdoren vetëm për ndarjen apo bashkimin e qendrave të votimit sipas ligjit, por në asnjë rast nuk mund të përdoren për afishim apo në faza të tjera të procesit zgjedhor. Gjithashtu, në format të posaçëm është edhe lista e zgjedhësve mbi 100-vjeçarë në datën e zgjedhjeve. Kjo listë i njoftohet kryetarit të bashkisë/njësisë bashkiake/komunës, për të bërë njoftimin e këtyre shtetasve për arsyen e mospasqyrimin në listë. Në format të posaçëm është edhe lista e zgjedhësve që e kanë numrin e qendrës së votimit të ndryshëm nga qendrat e votimit që i përkasin kësaj zyre të gjendjes civile.

4. Lista e zgjedhësve është e grupuar sipas zonave të qendrave të votimit. Kufijtë e zonave të qendrave të votimit janë ata të zgjedhjeve të fundit. Kryetari i bashkisë/komunës/njësisë bashkiake, i cili ka marrë njoftimin nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, vendos bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit.

5. Në rastet e qendrave të votimit me fraksion, që kalojnë limitin numerik të përcaktuar në ligj, kryetari vendos ndarjen e tyre, duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë, dhe jo çdo fraksion veç e veç. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi, me gjithë fraksionet e saj, në qarkun Tiranë, në njësitë vendore sipas vendimit të KQZ-së do të ndahet në pjesë të barabarta, me jo më shumë se, 700 zgjedhës dhe në të gjitha bashkitë e komunat e tjera me jo më shumë se 1000 zgjedhës.

6. Për qendrat e votimit me më pak se 200 zgjedhës, kryetari vendos bashkimin e kësaj qendre me një qendër më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor, shuma e numrit të zgjedhësve, të të cilave, duhet të jetë më shumë se 200 zgjedhës. Nëse shuma e numrit të zgjedhësve për qendrat që do të bashkohen është më shumë se 700 zgjedhës për qarkun Tiranë për njësitë vendore sipas vendimit të KQZ-së dhe 1000 zgjedhës për të gjitha bashkitë e komunat e tjera, atëherë kryetari pas bashkimit të këtyre qendrave vendos ndarjen me fraksion të qendrës së votimit të krijuar, sipas pikës 5 të këtij udhëzimi. Nëse dy a më shumë qendra votimi kanë më pak se 200 zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël zgjedhësish i bashkohen qendrës me numër më të madh zgjedhësish.

7. Vendimet e kryetarit për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit, nëse ka të tilla, do t'i dërgohen në formë shkresore zyrës së gjendjes civile për zbatim dhe Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, si dhe prefektit të qarkut përkatës për dijeni, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit nga zyra e gjendjes civile.





8. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, me marrjen e vendimit të kryetarit, për ndarjen qendrave të votimit brenda 24 orëve kryen veprimet e mëposhtme:

- Në menunë majtas zgjedh <administrimi i qendrave të votimit>, zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të ndahet, plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “Sipas vendimit nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2013 të kryetarit”, shtyp butonin <ruaj>. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast mosndryshimi, sistemi i RKGJC-së ekzekuton automatikisht kërkesën për ndarjen e qendrës së votimit sipas kriterit numerik dhe mbiemrit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës bazë. Në rast se kryetari ka vendosur që adresa e fraksionit është e ndryshme nga adresa e qendrës bazë, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile korrigjon adresën e qendrës së votimit me fraksion.

9. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile me marrjen e vendimit të kryetarit për bashkimin e dy a më shumë qendrave të votimit, brenda 24 orëve kryen veprimet si më poshtë: Në menunë majtas zgjedh <administrimi i qendrave të votimit>, zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të mbyllet, si dhe numrin e qendrës së votimit pritëse. Plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “Sipas vendimit nr. \_\_\_, datë \_\_\_. \_\_\_.2012 të kryetarit shtyp butonin <ruaj>. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast mosndryshimi, sistemi i RKGJC-së ekzekuton automatikisht kërkesën për bashkimin e qendrave të votimit sipas vendimit të kryetarit.

10. Procedura e përshkruar në pikat 4, 5, 6 dhe 7 do të zbatohet nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe nga kryetari përkatës, për çdo ekstrakt.

11. Në rast se kryetari nuk përmbush detyrimet sipas pikës 4, 5, 6 dhe 7 të këtij udhëzimi deri në publikimin e ekstraktit të fundit para publikimit të listës së zgjedhësve, DPGJC-ja kryen menjëherë ndarjen dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit, sipas kriterëve të përcaktuara në ligj, të cilat reflektohen në listat e zgjedhësve të datës 13 maj 2013.

12. Zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna/njësi bashkiake, brenda datës 3 janar 2013, printojnë dhe publikojnë, pasi të firmoset nga kryetari përkatës, ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve, sipas vendbanimit dhe qendrave të votimit, nën juridiksionin e tyre territorial.

Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë, me të njëjtat kritere, do të printohet dhe publikohet edhe çdo 30 ditë sipas përcaktimit të Kodit Zgjedhor.

DPGJC-ja publikon këto ekstrakte në shkallë vendi, në faqen e saj zyrtare, si dhe ia dërgon KQZ-së për publikim në faqen e saj zyrtare. Në momentin e publikimit të ekstraktit të radhës, nga faqet zyrtare fshihet ekstrakti i mëparshëm.

13. Kryetari i bashkisë/komunës/njësisë bashkiake, brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të parë, bën njoftimin me shkrim të zgjedhësve, të përfshirë në ekstraktin e printuar sipas qendrave të votimit brenda territorit të bashkisë/komunës/njësisë bashkiake përkatëse.

Njoftimi për shtetasit do të jetë sipas modelit nr. 1, i cili gjenerohet nga sistemi. Brenda këtij afati, kryetari njofton edhe shtetasit me moshë mbi 100 vjeç për arsyen e mospërfshirjes së tyre në listë. Njoftimi do të jetë sipas modelit nr. 2.

14. Zgjedhësit, të cilët kanë marrë njoftimin me shkrim nga ana e bashkisë/njësisë bashkiake/komunës dhe konstatojnë se në përbërësit e tyre zgjedhorë ka mospërputhje, i drejtohen zyrës së gjendjes civile përkatëse për të bërë rregullimet e mundshme.

15. Të drejtën për kërkesë e kanë dhe shtetasit që kanë mbushur moshën 100 vjeç. Këta shtetas do të bëjnë kërkesë për ndryshim të qendrës së votimit nga 8899 (qendër imagjinare e përdorur nga sistemi vetëm për këtë grup zgjedhësish), në qendrën e votimit sipas vendbanimit. Kjo kërkesë realizohet nëpërmjet formularit, sipas modelit nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

16. Krahas ndryshimit të përbërësve zgjedhorë në rrugë administrative, zyra e gjendjes civile do të pasqyrojë edhe rastet e vendimeve të gjykatës, deri në ditën e printimit të listës së zgjedhësve.

17. Çdo zyrë e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna, më datë 13.5.2013 printon

nga RKGJC-ja dhe firmos listën e zgjedhësve për çdo qendër votimi, duke përfshirë edhe institucionet e posaçme, nën juridiksionin territorial të saj dhe ia dorëzon kryetarit.

18. Kryetari miraton dhe firmos listën dhe e dërgon brenda datës 18.5.2013 në të tria formatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, në KZAZ-të përkatëse.

19. Një kopje e listës së zgjedhësve, në format të printuar, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila, jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, i dërgon për ruajtje listat e printuara në Arkivin Qendror të Shtetit.

20. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen kryetarët e bashkive/komunave/njësive bashkiake, Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, punonjësit e ZGJC-ve në bashki/komuna/njësi bashkiake dhe institucionet e tjera shtetërore që parashikohen në Kodin Zgjedhor.

21. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM  
FLAMUR NOKA

### MODEL 2

DATA E ZGJEDHJEVE: 23/06/2013

QARKU: \_\_\_\_\_

Bashkia/Njësia bashkiake/Komuna: \_\_\_\_\_

Numri i banesës: \_\_\_\_\_

Z./Znj. \_\_\_\_\_

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, sipas nenit 51 të Kodit Zgjedhor nuk jeni të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit si shtetas që keni mbushur 100 vjeç. Sipas nenit 53 të Kodit Zgjedhor për tu përfshirë në listën e zgjedhësve, kërkesa e juaj duhet të bëhet pranë zyrës suaj të gjendjes civile.

### KRYETARI

\_\_\_\_\_  
(Emër, Mbiemër, Firma)

### KËRKESË

Drejtuar: Bashkisë/Njesisë Bashkiake/Komunës : \_\_\_\_\_

Unë i quajtur i \_\_\_\_\_ banor i Bashkisë/ Njesisë Bashkiake / Komunës  
(emër, atësi, mbiemër)

\_\_\_\_\_ pasi mora njoftimin nga Kryetari se nuk jam i përfshirë në listën e zgjedhësve, kërkoj nga ana juaj, të më shtoni në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit Nr \_\_\_\_\_ , aty ku janë të regjistruar dhe pjesëtarët e tjerë të familjes.

Emër, Mbiemër

\_\_\_\_\_  
(nënshkrimi)

Data: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.12.2012  
Doli nga shtypi më 24.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 12 lekë